

Statistikat e Transportit Rrugor

Tremujori IV, 2023

Tiranë, më 29 Janar 2024: Gjatësia e rrjetit rrugor në shfrytëzim është 3.606* km, klasifikuar sipas kategorive të ndryshme, si autostradë, rrugë interurbane kryesore, rrugë interurbane dytësore, rrugë urbane dhe rrugë lokale. Rrugët interurbane dytësore zënë rreth 74,2 % të gjatësisë së rrjetit rrugor.

Në tremujorin e katërt 2023, numri gjithsej i mjeteve rrugore me status "aktiv" dhe "të çregjistruar përkohësisht" që qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në Dhjetor 2023 rezulton 867.765 mjete.

Në kategorinë e mjeteve rrugore sipas llojit, përqindjen më të madhe ndaj numrit gjithsej të mjeteve rrugore e zënë "Autoveturat" (80,6 %), "Automjetet për transport të përzier" (6,2 %) dhe "Motor" (5,5 %).

Tab 1: Mjetet rrugore sipas llojit

Mjete rrugore sipas llojit	TR I -2023	TR II -2023	TR III -2023	TR IV-2023
Gjithsej	809.024	828.306	848.127	867.765
Autoveturë	649.797	665.970	682.806	699.337
Automjet për transport të përzier	52.079	52.614	53.121	53.915
Motor	43.711	45.218	46.855	48.027
Kamion	15.100	15.259	15.431	15.651
Autobus	8.285	8.379	8.456	8.562
Automjet për transport të veçantë	8.025	8.171	8.281	8.441
Automjet për përdorim të veçantë	4.353	4.420	4.453	4.540
Rimorkio për transport mallrash	1.793	1.819	1.856	1.888
Të tjera	25.881	26.456	26.868	27.404

Burimi: Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Ilogaritje INSTAT

Në tremujorin e katërt 2023, numri më i lartë i mjeteve rrugore është regjistruar në qarkun e Tiranës, duke zënë 34,7 % të mjeteve rrugore gjithsej të regjistruara në vend, pasuar nga qarku i Durrësit me 13,4 % të mjeteve rrugore gjithsej.

Qarqet me numrin më të vogël të mjeteve rrugore janë qarku i Gjirokastrës me 2,2 % dhe qarku i Kukësit me 2,3 % të mjeteve rrugore gjithsej.

* Treguesi i gjatësisë së rrugëve dhe klasifikimit të tyre i referohet vetëm rrugëve të cilat janë nën administrimin e ARRSH-së.

Tab 2: Mjete rrugore sipas qarqeve

Qarqet	TR I -2023	TR II -2023	TR III -2023	TR IV-2023
Gjithsej	809.024	828.306	848.127	867.765
Berat	33.014	33.714	34.464	35.267
Dibër	22.504	23.037	23.685	24.362
Durrës	108.058	110.922	113.748	116.639
Elbasan	56.068	57.111	58.502	60.119
Fier	75.370	76.997	78.965	80.582
Gjirokastrë	17.943	18.233	18.608	18.991
Korçë	40.601	41.338	42.299	43.459
Kukës	18.900	19.328	19.802	20.319
Lezhë	40.414	41.152	42.099	43.029
Shkodër	58.148	59.247	60.565	61.882
Tiranë	280.651	288.265	294.843	300.998
Vlorë	57.353	58.962	60.547	62.118

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Ilogaritje INSTAT

Marka “Mercedes Benz” është marka me qarkullim më të lartë në vend në kategorinë e mjeteve rrugore me 18,0 %, e ndjekur nga marka “Volkswagen” me 15,8 % dhe “Daimler Chrysler” 8,8 %.

Tab 3: Mjete rrugore sipas markës

Marka e mjeteve rrugore	TR I -2023	TR II -2023	TR III -2023	TR IV -2023
Gjithsej	809.024	828.306	848.127	867.765
MERCEDES BENZ	146.642	149.608	153.057	156.603
VOLKSWAGEN	124.417	128.674	132.969	137.419
DAIMLER CHRYSLER	74.910	75.452	75.957	76.459
FORD	69.647	70.577	71.503	72.319
AUDI	38.157	40.191	42.492	44.831
OPEL	34.315	34.702	35.019	35.289
TOYOTA	32.090	33.240	34.471	35.661
FIAT	29.608	30.235	30.635	31.035
BMW	22.623	23.151	23.734	24.361
RENAULT	18.897	19.061	19.142	19.161
PEUGEOT	13.337	13.479	13.654	13.745
NISSAN	13.305	13.636	13.980	14.324
LAND ROVER	10.597	10.919	11.301	11.704
MITSUBISHI	9.919	9.978	10.083	10.138
HYUNDAI	9.816	10.245	10.753	11.447
CITROEN	9.578	9.727	9.878	9.989
DAYANG	9.318	9.661	10.101	10.437
VOLVO	7.568	7.938	8.307	8.741
SKODA	7.291	7.649	7.872	8.131
SMART	6.672	6.762	6.866	6.980
YAMAHA	6.505	6.675	6.822	6.955
TE TJERA	113.812	116.746	119.531	122.036

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Ilogaritje INSTAT

Gjatë tremujorit të katërt 2023, janë regjistruar për herë të parë 21.900 mjete rrugore. Në kategorinë e mjeteve rrugore sipas llojit të regjistruar për herë të parë, përqindjen më të madhe ndaj numrit gjithsej të mjeteve rrugore e zënë “Autoveturat” (84,6 %) dhe “Motor” zënë (5,4 %).

Tab 4: Mjete rrugore sipas llojit. të regjistruara për herë të parë

Mjete rrugore sipas llojit	TR IV -2022	TR IV -2023	Ndryshimi në %
Gjithsej	14.395	21.900	52,1
Autoveturë	11.955	18.534	55,0
Automjet për transport të përzier	612	949	55,1
Motor	845	1.172	38,7
Kamion	159	231	45,3
Autobus	116	128	10,3
Automjet për transport të veçantë	124	170	37,1
Automjet për përdorim të veçantë	88	87	-1,1
Rimorkio për transport mallrash	30	38	26,7
Të tjera	466	591	26,8

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Ilogaritje INSTAT

Numri më i lartë i mjeteve rrugore të regjistruara për herë të parë, është në qarkun e Tiranës, duke zënë 38,3 % ndaj mjeteve rrugore gjithsej të regjistruara në vend në tremujorin e katërt 2023.

Qarqet me numrin më të vogël të mjeteve rrugore të regjistruara për herë të parë, janë qarku Gjirokastrër me 1,3 % dhe qarku Dibër me 2,2 % ndaj mjeteve rrugore gjithsej.

Tab 5: Mjete rrugore sipas qarqeve. të regjistruara për herë të parë

Mjete rrugore sipas qarqeve	TR IV 2022	TR IV 2023	Ndryshimi në %
Gjithsej	14.395	21.900	52,1
Berat	558	758	35,8
Dibër	335	474	41,5
Durrës	2.381	3.605	51,4
Elbasan	997	1.461	46,5
Fier	1.402	2.005	43,0
Gjirokastrër	160	281	75,6
Korçë	499	805	61,3
Kukës	362	479	32,3
Lezhë	565	891	57,7
Shkodër	810	1.286	58,8
Tiranë	5.429	8.385	54,4
Vlorë	897	1.470	63,9

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Ilogaritje INSTAT

Marka “Volkswagen” është marka me qarkullim më të lartë në vend në kategorinë e mjeteve rrugore të regjistruara për herë të parë me 21,8 %, e ndjekur nga marka “Mercedez Benz” me 17,5 %.

Tab 6: Mjete rugore sipas markës. të regjistruara për herë të parë

Mjete rugore sipas markës	TR IV -2022	TR IV -2023	Ndryshimi në %
Gjithsej	14.395	21.900	52,1
VOLKSWAGEN	2.894	4.779	65,1
MERCEDEZ BENZ	2.474	3.838	55,1
AUDI	1.264	2.454	94,1
FORD	944	1.084	14,8
TOYOTA	893	1.230	37,7
DAIMLER CHRYSLER	617	674	9,2
FIAT	444	532	19,8
BMW	478	681	42,5
OPEL	376	456	21,3
TE TJERA	4.011	6.172	53,9

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Ilogaritje INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë tremujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

Transporti rrugor: Çdo lëvizje e mallrave duke përdorur një mjet rrugor në një rrjet të caktuar rrugor.

Autoveturë - Mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh, në të cilin numri i vendeve të uljes (duke përfshirë edhe shoferin) nuk e kalon numrin 9.

Autobus - Mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh me numrin e vendeve të uljes (duke përfshirë dhe vendin e shoferit) me më shumë se 9 vende.

Kamion - Mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave.

Motor - Mjet motorik i transportit rrugor me dy, tre ose katër rrota që nuk i kalon 400 kg peshë pa ngarkesë.

Rimorkio për transport mallrash - Mjet rrugor për transportin e mallrave i projektuar për t'u tërhequr nga një mjet motorik i transportit rrugor.

Automjete për transport të përzier (ATP) - Përfshihen mjetet që kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjësë, duke përfshirë dhe ndenjësën e drejtuesit të mjetit.

Automjete për transport të veçantë (ATV) - Mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të vecanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përbashkët, me mekanizma special që i shërbejnë këtij qëllimi.

Automjete për përdorim të veçantë (APV) - Mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të veçantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe i materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i katërt, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i katërt, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: transport rrugor, hekurudhë, transport ujor i brendshëm dhe transport detar.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash